



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës Veriore

Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

Kryetari i Komunës.

Nr. _____ . Data: 24/04/2024.

Mitrovicë Veriore.

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale, neni 31 të Statutit të Komunës të datës 15.05.2014, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kontratën e Prokurimit ‘Hartimi i Projekteve’ me Nr. 647-23-12454-2-1-1 si dhe Propozim-Vendimit Nr. 01-030/01-0004923/24 të datës 23.04.2024 të Drejtorisë për Shërbime Publike, Infrastrukturë, Inspektion dhe Situata Emergjente, Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, sjell këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Komisionit për Pranimin dhe Miratimin e Projekteve ideore në realizimin e Kontratës ‘Hartimi i Projekteve’)

1. Formohet Komisioni për Pranimin dhe Miratimin e Projekteve ideore sipas Kontratës ‘Hartimi i Projekteve’, me këtë përbërje:
 - 1.1 Merita Jashanica, kryesuese;
 - 1.2 Abedin Pllana, anëtar;
 - 1.3 Albin Kelemdni, anëtar.
2. Komisioni është përgjegjës të bëjë kontrollimin e projektit ideor dhe të bëjë pranimin dhe miratimin e tij gjatë ekzekutimit të punëve në realizimin e Kontratës me titull: ‘**Hartimi i Projekteve**’. (Kontratën Publike Kornizë me numër identifikues 647-23-12454-2-1-1 të datës 16.01.2024)
3. Komisioni i emëruar bazë për punën e tij do të ketë Rregullorën Financiare Nr. 01/2013/MF Shpenzimi i parasë publike, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
4. Komisioni i emëruar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi ka mandat deri në Përfundimin e Kontratës Publike Kornizë me numër identifikues 647-23-12454-2-1-1 të datës 16.01.2024 me titull: ‘**Hartimi i Projekteve**’.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore

1

I dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit
- 1x1 Zyrës ligjore
- 1x1 Anetarëve të Komisionit.
- 1x1 Arkivit